



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembl*

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Mbledhja nr. 18

Prishtinë, më 22. 10.2013, në orën 10.00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

**Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e Komisionit:** Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Kymete Bajraktari, Albana Gashi dhe Kimete Bytyçi.

**Munguan:** Justina Shiroka - Pula dhe Duda Balje.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Reshit Gashi – Zyrtar i lartë ligjor, Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

**Te ftuar:** Sami Kurteshi-Avokat i Popullit dhe Isa Hasani-Zëvendës Avokat i Popullit.

**Pjesëmarrësit e tjerë:** Dren Rexha-UNICEF, Florie Kryeziu- UNDP, Visar Bivolaku-EUSR/EUO, Aleksandra Nicic- RTK 2, Astrit Veliqi -Kosovalive, Raba Gjoshi-YIHR-Kosova, Nuredin Ibishi -UNDP, Elita Vokshi-OSBE, Lejla Selimi-OSBE dhe Sead Bardhi-ZPRK.

**Mbledhjen e kryesoi,** Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8 tetor 2013;

3. Shqyrtimi i Raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit për të drejtat e fëmijëve;
5. Të ndryshme.

**Kryetarja** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe vazhdoi sipas rendit të ditës:

**1. Miratimi i rendit të ditës.**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8. 10. 2013.**

U vendos që procesverbali të miratohet ne mbledhjen e radhës për shkak se nuk ka arritur të përkthehet në gjuhën serbe.

**3. Shqyrtimi i Raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012.**

**Kryetarja** – I njoftoi anëtarët e Komisionit se Raporti i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012 është në shqyrtim dhe lidhur me këtë është ftuar në takim Avokati i Popullit, Sami Kurteshi. Ajo, po ashtu, i njoftoi anëtarët e Komisionit se Avokati i Popullit do të jetë prezent në takim në orën 11 : 00, për shkak të disa obligimeve që ka pasur nuk ka mundur të vijë në orën 10:00. Ajo propozoi që me këtë pikë të rendit të ditës të vazhdohet në orën 11 : 00, atëherë kur do të vijë Avokati i Popullit, ndërsa tani të vazhdohet me pikat e tjera të rendit të ditës.

**4. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit për të drejtat e fëmijëve.**

**Kryetarja** – I njoftoi anëtarët e Komisionit se është përgatitur një raport lidhur me monitorimin e rekomandimeve për të drejtat e fëmijëve, mirëpo ajo kërkoi mendimin e anëtarëve se a të dërgohet raporti në Kuvend për njoftim apo edhe për shqyrtim dhe miratim? Nëse shkojnë vetëm me informatë ajo do të mbetet vetëm informacion për Kuvend, ndërsa nëse shkohet me rekomandime atëherë duhet të miratohen serish rekomandimet e paraqitura në raport dhe në këtë mënyrë dalin obligime për institucionet. Ajo ishte e mendimit që të paraqiten me rekomandime, mirëpo për të vendosur lidhur me këtë ajo kërkoi mendimin e anëtarëve të Komisionit.

**Kymete Bajraktari** – Ishte e mendimit që raporti të procedohet në Kuvend së bashku me rekomandimet, sepse në këtë mënyrë paraqiten rezultatet që kanë dalë nga monitorimi i zbatimit të rekomandimeve për të drejtat e fëmijëve.

**Kymete Bytyqi** – Duke u bashkangjitur mendimit të parafolësës tha se raporti duhet të paraqitet në Kuvend së bashku me rekomandimet.

**Albana Gashi** – U pajtua me idenë që raporti të procedohet së bashku me rekomandimet, sepse institucionet që janë kompetentë për zbatimin e këtyre rekomandimeve duhet të japin llogari për moszbatimin e tyre.

**Kurtan Kajtazi** –Ishte i mendimit që raporti të dërgohet në seancë vetëm si informacion, mirëpo nëse Komisioni vendos që ta procedojë së bashku me rekomandimet atëherë ai tha se duhet të harmonizohen rekomandimet në Komision, e pastaj të procedohen në Kuvend. Ai propozoi që shqyrtimin e rekomandimeve ta bëjnë në takimet e radhës së Komisionit.

**Kryetarja** – Nuk ishte e pajtimit që të shtyhet shqyrtimi i rekomandimeve për takimet e radhës, sepse pikërisht për shkak të rekomandimeve është shtyrë vendimi në mbledhjen e kaluar.

Me shumicë votash, 5 vota pro dhe një abstenim ( **Kurtan Kajtazi** ) u vendos që raporti të procedohet në Kuvend së bashku me rekomandimet.

**Kryetarja** - I njoftoi Komisionin se në parim është miratuar Plani i Punës së Komisionit për vitin 2013, mirëpo periudha shtator – dhjetor 2013 është kompletuar dhe tani duhet që sërish të miratohet nga anëtarët e Komisionit. Ajo tha se ky plan është bërë në bazë të Strategjisë Legjislative, mirëpo ligjet e parapara ende nuk kanë arritur në Kuvend.

**Kymete Bajraktari** – Tha se në muajin tetor është i planifikuar shqyrtimi i Projektligjit për Liritë fetare në Kosovë. Mirëpo ai ende nuk ka ardhur dhe ne e kemi vendosur në muajin tetor. Pastaj ajo tha se është në plan Plotësim- Ndryshimi i Ligjit për Barazinë Gjinore në Kosovë. Ajo ishte e mendimit se po krijohet një paqartësi në lidhje me këtë çështje, sepse nuk ka afat të saktë se kur do arrijnë këto projektligje në Kuvend.

**Kryetarja** – Theksoi se të gjitha këto vendosen në plan varësisht prej kohës që arrijnë në Kuvend.

**Kymete Bajraktari** – Ishte e mendimit se më mirë është që në muajin tetor të vendosen detyrat që dalin nga Raporti i Progresit. Po ashtu te organizimi i Dëgjimit Publik për monitorimin e ligjit për personat e zhdukur ajo tha se si do të mbahet dëgjimi publik kur asnjë aktivitet tjetër përveç dërgimit të pyetësorëve nuk është bërë. Ajo ishte e mendimit se ky aktivitet të mbahet në muajin nëntor pasi që në atë muaj mund të krijohen kushtet për mbajtjen e këtij dëgjimi.

Pas këtyre konstatimeve me votim unanim nga anëtarët e Komisionit u vendos që të miratohet Plani i Punës për periudhën shtator – dhjetor 2013.

## 5. Të ndryshme

**Kryetarja** – I njoftoi anëtarët e Komisionit se ka arritur një kërkesë nga zëvendësavokati i Popullit, e cila do të shqyrtohet në takimet e radhës.

**Albana Gashi** – Tha se mbledhjen e kaluar ishte një kërkesë jo e definuar mirë, e cila kishte të bënte me grupin e punëtorëve nga ndërmarrja “ Suhareka “ dhe ka mbetur që në këtë takim të vendoset se cilat veprime konkrete do të dalin nga Komisioni. Ajo tha se është konsultuar me anëtarin e Komisionit znj. Kimete Bytyqi, si dhe Grupin Parlamentar dhe janë akorduar që të mblidhen nënshkrime me qëllim të mbajtjes së një seance të jashtëzakonshme, ose një debat parlamentar lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve që janë privatizuar me Spin Of Special dhe të cilat nuk e kanë vazhduar veprimtarinë. Ajo tha se kjo është ide, e cila pret të përkrahet nga anëtarët e tjerë të Komisionit. Ajo theksoi se edhe nëse nuk merret si iniciativë e Komisionit, ajo do të merret si iniciativë nga nënshkrimet e mbledhura.

**Kymete Bajraktari** – Kërkoi sqarime se a po kërkohet që Komisioni të kërkojë debat parlamentar ose si qëndron situata.

**Rita Hajzeraj – Beqaj** – Ishte e mendimit që më shumë peshë ka nëse merret iniciativa si Grup Parlamentar. Ajo tha se nuk është çështja vetëm të ndërmarrjet që janë privatizuar me Spin Of Special, por edhe të ndërmarrjet e tjera, të cilat janë privatizuar në mënyrë të rregullt në të cilat janë të ndaluara të privatizohet 20 % i punëtorëve.

**Albana Gashi** – E njoftoi Komisionin se në të kaluarën është mbajtur një debat parlamentar rreth privatizimit. Mirëpo në Komision vazhdimisht po marrin ankesa lidhur me privatizimet që janë bërë me Spin Of Special dhe nuk e kanë vazhduar veprimtarinë e caktuar. Për këtë arsye ajo ishte e mendimit që të merret iniciativa, sepse për privatizimin në përgjithësi është debatuar njëherë.

**Kryetarja** – Tha se e përkrahë këtë iniciativë që sipas mendimit të saj është iniciativë me vend.

**Kurtan Kajtazi** – Ishte i mendimit që kjo çështje të diskutohet në takimet e tjera dhe sipas mendimit të tij nuk është kompetencë e Komisionit. Kjo sepse bie në fushëveprimin e komisioneve të tjera. Edhe ai ishte i mendimit që më shumë peshë ka nëse kërkohet nga grupet parlamentare.

**Kryetarja** propozoi që kjo çështje të vihet në rend dite në takimin e radhës pasi që lidhur me këtë shfaqë pakënaqësinë e tij deputeti Kurtan Kajtazi.

**Kymete Bajraktari** – Theksoi se ajo është pro debatit dhe do të votojë pro, mirëpo kishte dyshime se në çfarë mënyrë do të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit që të debatohet lidhur me këtë çështje.

**Kryetarja** – Theksoi se pasi që ka paqartësi lidhur me këtë çështje të obligohet stafi i Komisionit që ta konsultojë Rregulloren e Kuvendit, në mënyrë që të vërtetohet se a ka të drejtë Komisioni që të iniciojë një çështje të tillë në mënyrë që të futet në rend të ditës në takimet e ardhshme.

Pasi që kishte mendime të ndryshme lidhur me këtë çështje se a të votohet tani, apo të shtyhet kjo kërkesë nga Komisioni, kryetarja kërkoi mendimin e anëtarëve të Komisionit. Pasi që shumica e anëtarëve prezent ishin të mendimit që të shtyhet votimi i kësaj kërkesë nga ana e Komisionit u vendos që në takimet e ardhshme të futet në rend dite kjo çështje dhe të merret vendim.

### **3. Shqyrtimi i Raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012**

**Kryetarja** i njoftoi anëtarët e Komisionit se e kanë marrë raportin në mënyrë elektronike por ka qenë i dërguar edhe te kutitë postare të deputetëve dhe pastaj ia kaloi fjalën Avokatit të Popullit.

**Sami Kurteshi** – Pasi i përshëndeti të pranishmit theksoi se Raporti është paraqitur me disa muaj vonesë. Ai tha se për shkak të ngarkesave shumë të mëdha që ka pasur Institucioni i Avokatit të Popullit ka rezultuar me vonesën e raportit edhe pse kjo çështje nuk e arsyeton vonesën. Ai duke u ndërlidhur me ngarkesën e punëve të ky institucion tha se në gjashtëmujorin e parë të këtij viti ka pasur ngritje të rasteve të paraqitura për 60 % më shumë se sa vitin e kaluar. Ai po ashtu e theksoi se ka pasur vonesa edhe për shkak të përkthimit joprofesional nga kompania e kontraktuar e cila nuk e ka përkthyer si duhet raportin në gjuhën serbe dhe angleze dhe pastaj ata janë detyruar që ta përkthejnë vet raportin në gjuhën serbe dhe kjo ka qenë arsye shtesë e cila ka rezultuar me mungesën e paraqitjes së Raportit Vjetor në Kuvend. Sa i përket përbërjes strukturore të raportit ai tha se raporti nuk ka ndryshime strukturore nga vitet e kaluar mund të ketë ndryshime të vogla teknike, mirëpo në strukturë nuk ka ndryshime. Ai tha se i janë përmbajtur kapitullit të dytë të Kushtetutës në bazë të të cilit kanë hartuar raportin. Ai, po ashtu, theksoi se janë munduar që t'i përfshijnë në raport të gjitha të drejtat të cilat garantohen me Kushtetutë. Duke u ndërlidhur me përmbajtjen e raportit ai tha se në një pjesë të raportit janë paraqitur pjesa statistikore, si dhe pjesa e shpenzimeve apo raporti financiar. Sa i përket vëllimit të punëve të këtij institucioni ai theksoi se numri i raporteve të veçanta si dhe rasteve ex officio janë dyfishuar që nënkupton faktin se është rritur dukshëm vëllimi i punëve.

**Kryetarja** – Tha se e ka analizuar këtë raport dhe e ka krahasuar me raportin e vitit të kaluar dhe ka konstatuar se në këtë raport mungon diskriminimi që është një çështje shumë më rëndësi. Duke u ndërlidhur me përmbajtjen e raportit ajo theksoi se te raportet e policisë për rastet e dhunës në familje janë të përfshira vetëm tri komuna e në fakt Kosova ka shumë më shumë komuna të cilat nuk janë përfshirë. Po ashtu në përmbajtje të këtij raporti ajo tha se ka vërejtur se te pjesa që flet për gratë dhe vajzat e dhunuara gjatë luftës në Kosovë figuron shifra e 20000 gra dhe vajza të dhunuara e në realitet ata nuk kanë një statistikë të saktë lidhur me këtë çështje. Dhe ajo ishte e mendimit që kjo shifër nuk është dashur që të përmendet në raport. Gjithashtu te e drejta e jetës ajo theksoi se

IAP ka rekomanduar që Instituti Gjyqësor i Kosovës të vazhdojë më trajnime të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën penale, në veçanti në fushat që kanë të bëjnë me të drejtën për jetë. Ajo kërkoi sqarime se pse kanë rekomanduar për një gjë të tillë d.m.th. pse kanë rekomanduar mbajtjen e këtyre trajnimeve. Ajo kishte vërejtje të disa fusnota që si referencë kanë Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, sipas saj kjo nuk është e nevojshme pasi që tani ekziston Kodi i ri Penal i Kosovës. Lidhur me disa çështje të zvarritjeve të procedurave gjyqësore, si dhe shqiptimin e dënimeve të ulëta në raport figuron se si bazë e informacioneve kanë qenë gazetatat ditore. Ajo ngriti dilema se sa mund të merren për bazë tekstet e gazetave për t'i përfshirë në raport këto çështje, sepse sipas mendimit të saj lidhur me këto informacione është dashur të kontaktohet Këshilli gjyqësor. Lidhur me lirinë e lëvizjes ajo tha se i është kushtuar shumë vëmendje mungesës së transportit në Graçanicë dhe Lapllasellë ndërsa lirisë së lëvizjes në Mitrovicën e veriut i është kushtuar fare pak rëndësi, gjë që mund të konstatohet se te kjo çështje nuk kemi baraspeshë. Lidhur me shkurorëzimin ajo theksoi se është dhënë një rekomandim i cili tregon se gjykatat janë të paanshme sa i përket diskriminimit gjinore në caktimin e kujdestarisë së fëmijëve në rastin e shkurorëzimit. Sa i përket sistemit arsimor ajo tha se në këtë raport është cekur se komuniteti serb në Kosovë punon në bazë të plan-programit të Serbisë dhe të punësuarit marrin paga të dyfishta dhe në këtë rast ka munguar rekomandimi nga IAP që kjo çështje të ndryshojë dhe të punohet me plan-program të Kosovës. Ajo, po ashtu, theksoi se në pjesën e raportit ku flitet për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë do të kishte qenë mirë që të përmendet edhe Ligji për Procedurën Përmbarimore. Në fund ajo tha se nga faqja 96 e raportit e deri në fund edhe pse janë përmendur shumë gjëra që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve, kthimin e personave, mirëpo rekomandime lidhur me këto çështje nuk ka, d.m.th. mungojnë rekomandimet për këto. Sa i përket pjesës së raportit ku flitet për bashkëpunimin me Kuvendin, ajo shfaq kundërshtimin e saj për citimin në raport ku thuhet se nuk ka marrë përgjigjeje IAP se a janë marrë parasysh raportet e dërguara te Kuvendi, sepse siç tha ajo janë mbajtur shumë takime me institucionet e Republikës së Kosovës me qëllim të vërtetimit se a janë marrë parasysh rekomandimet e dalluara nga raportet e IAP-së dhe për këtë çështje kanë marrë lëvdata edhe nga Komisioni Evropian. Në fund ajo tha se është gabim një konstatim i tillë nga ana e IAP – së, sepse në çdo takim të Komisionit kanë qenë të ftuar kur janë shqyrtuar rekomandimet e dala nga raportet e IAP-së.

**Sami Kurteshi** – Duke u ndërlidhur me pyetjet theksoi se sa i përket dhunës në familje ata janë bazuar në statistikat zyrtare që kanë nxjerrë këto përfundime. Sa i përket faktit që kanë paraqitur statistika të vetëm tri komunave ai theksoi se i kanë pasur statistikat vetëm të këtyre tri komunave. Sa i përket numrit të grave të dhunuara gjatë luftës ai tha se është vërejtje me vend e cila nuk do të publikohet në raportin final. Sa i përket vërejtjes për mos përfshirjes së diskriminimit ai tha se këtë e kanë bërë në mënyrë të shpërndarë, sepse ka diskriminim në fusha të ndryshme. Ai, po ashtu, tha se lidhur me rekomandimin e Institutit Gjyqësor për gjyqtarë dhe prokurorë ata kanë rekomanduar për fushën penale, respektivisht për të drejtën e jetës.

**Isa Hasani** – Sqaroi se lidhur me rekomandimet që i janë drejtuar Institutit Gjyqësor për mbajtjen e trajnimeve ai tha se për bazë kanë marrë ankesat e qytetarëve që janë drejtuar te Institucioni i Avokatit të Popullit.

**Sami Kurteshi** – Tha se është gabim teknik fusnota e cila bazohet në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës. Lidhur me disa të dhëna të tjera të cilat janë bazuar në gazeta ai tha se si pikë reference e kanë marrë shkrimin e gazetës Koha Ditore. Sa i përket lirisë së lëvizjes ai tha se e kanë theksuar qartë se në veriun e Kosovës nuk ka liri të lëvizjes dhe më tutje nuk kanë pasur se çka të shkruajnë rreth kësaj çështje.

**Isa Hasani** – Duke u bazuar në vërejtjen se në raport mungon përfshirja e noterisë ai tha se ky institucion ka filluar të veprojë nga viti 2013 dhe kjo do të përfshihen në Raportin e vitit 2013.

**Sami Kurteshi** – Tha se sa i përket mungesës së rekomandimit për unifikimin e arsimit kjo është çështje politike dhe për këtë arsye ata nuk kanë mundur të bëjnë rekomandime. Lidhur me pjesën e raportit që nuk ka rekomandime ai tha se ata bëjnë rekomandime në atë pjesë ku e konsiderojnë të nevojshme që të bëhen rekomandime.

**Albana Gashi** – Duke u ndërlidhur me përmbajtjen e raportit theksoi se te pjesa që flitet për gratë dhe vajzat e dhunuara gjatë luftës në Kosovë është tentuar që edhe kjo kategori të futet në Ligjin për Vlerat e Luftës. Mirëpo rekomandimet për këtë çështje janë hedhur poshtë. Sa i përket termit gratë dhe vajzat e dhunuara ajo kishte vërejtje në këtë emërtim, sepse sipas mendimit të saj gjatë luftës të gjitha kategoritë kanë qenë të dhunuara si gratë, burrat ashtu edhe fëmijët. Ajo kërkoi sqarime se cilat rekomandime janë hedhur poshtë që ceket në raport. Ajo ishte kundër idesë që gratë dhe vajzat e dhunuara të përfshihen në një ligj të veçantë, sepse ideja ka qenë që kjo kategori është kategori e dalë nga lufta dhe ka qenë kërkesë e tyre që të përfshihen në ligjin për vlerat e luftës. Sa i përket pjesës së raportit ku flitet për të drejtën për jetën ajo tha se është përdorur vetëm një definicion i shkurtë dhe nuk ka parë ndonjë rast që është përmendur duke u fokusuar në rastin e vrasjes së Selver Haradinaj. Sa i përket lirisë së lëvizjes ajo tha se te komuniteti shqiptar nuk janë përmendur pengesat që shkaktojnë mungesën e lirisë së lëvizjes, pastaj pengesat në ndërtimin e shtëpive të tyre, madje janë sulmuar në raste të tilla. Sa i përket lirive fetare, përkatësisht Kisha Ortodokse. Ajo tha se të njëjtën vërejtje e ka pasur edhe në raportin e vitit të kaluar dhe të njëjtën e ka edhe tani ku janë paraqitur disa raste të dëmtimit të kishave dhe përmendoreve dhe sipas mendimit të saj ata janë bazuar në mediumet serbe. Ajo bëri pyetje lidhur me këtë çështje se a kanë pasur ndonjë ankesë lidhur me këtë çështje, a kanë dalë ne të terren për vërtetimin e gjendjes apo vetëm janë bazuar te mediat serbe.

**Sami Kurteshi** – Tha se ka të drejtë sa i përket emërimit gratë e dhunuara gjatë luftës, sepse duhet të përfshihen edhe kategoritë e tjera, sepse dhunimi është përdorur si mjet i luftës. Ai tha se ka mundësi që janë dhunuar edhe meshkuj dhe kjo do të kishte qenë mirë që të përfshihen. Sa i përket ligjit për këtë kategori ai tha se për IAP-në nuk ka rëndësi se me çfarë ligji vendos Kuvendi ta rregullojë këtë çështje, me rëndësi është që kjo kategori të ketë të drejtat e veta të garantuara me ligj. Lidhur me rastet te e drejta për jetën ai tha

se nuk është përmendur rasti i Selver Haradinaj për arsye se ky rast ende është i hapur te IAP-ja.

**Albana Gashi** - Tha se do të kishte qenë mirë që të përmenden pengesat sa i përket lirisë së lëvizjes në pjesën veriore të Kosovës, pasi që nga këto rezultate po del se vetëm komunitetet janë të diskriminuara. Ajo e theksoi se asnjë vend nuk është cekur në raport që shqiptarët e kanë të pamundur vendosjen në shtëpitë e tyre në veri.

**Sami Kurteshi** – Tha se e kanë diskutuar çështjen e transportit humanitar, mirëpo jo në të gjitha pjesët ku ka nevojë për transport humanitar. Ai tha se për çështjen e transportit për pjesën veriore nuk kanë pasur ankesa. Lidhur me dëmtimet e Kishës Serbe dhe marrjen e burimeve nga mediat serbe, ai tha se është pjesërisht vërejtje me vend, por ata janë munduar të mënjanojnë burimet e Kishës Ortodokse për arsye se Kisha ka qëndrime politike ndaj Kosovës.

**Albana Gashi** – Duke u ndërlidhur theksoi se ajo ka shumë dyshime sa i përket këtyre dëmtimeve, sepse nuk mund të bazohet vetëm te mediat serbe. Ka pasur shumë raste kur është vërtetuar krejt e kundërta çka është thënë në media, shkak i propagandës që kanë pasur.

**Sami Kurteshi** – Lidhur me këto çështje tha se i kanë parë, por edhe kanë pranuar raporte të policisë që i kanë dëshmuar këto dëmtime.

**Kryetarja** në këto momente e ka lëshuar takimin për shkak të një çështje me rëndësi dhe këtë takim e ka udhëhequr nënkryetarja e parë, Rita Hajzeraj – Beqaj.

**Kimete Bytyqi** – Duke u ndërlidhur me përmbajtjen e raportit theksoi se në raport janë cekur rastet e vrasjeve që kanë ndodhur në vitin 2012, por nuk janë cekur rastet që janë zhdukur dhe ishte e mendimit që kjo të ceket. Sa i përket çështjes së arsimit ajo tha se po bëhet diskriminim ndaj minoriteteve romë dhe turq, sepse atyre po u bëhet plan-programi në gjuhën shqipe, kurse minoritetit serb jo. Ajo tha se në territorin e Kosovës punohet me një plan-program arsimor, pa marrë parasysh se cilit komunitet i takojnë.

**Sami Kurteshi** – Tha se të dhënat lidhur me personat e vrarë janë marrë nga statistikat e policisë dhe nuk ka informacione se a janë përfshirë këtu edhe personat e zhdukur gjatë vitit 2012. Sa i përket çështjes së arsimit ai tha se qëllim parimor i institucionit është arsimimi. Ndërsa çështja e pagave të dyfishta ai tha se kjo është politike dhe nuk është punë e tyre.

**Kimete Bytyqi** – Ishte e mendimit se përderisa ata refuzojnë të punojnë me plan-programin e Kosovës nuk është në rregull që të paguhen nga Buxheti i Kosovës.

**Biserka Kostiq** – Duke u ndërlidhur me përmbajtjen e raportit tha se te përdhosja e varrezave serbe nuk është në faqen e njëjtë që është edhe në gjuhën shqipe. Sa i përket dëmtimit të Kishës ajo tha se a dyshohet në punën e drejtë të mediave serbe, ajo pyeti se pse mediat serbe do të paraqitnin fakte të tilla nëse ato nuk do të ekzistonin, pse



polemizohet lidhur me këtë kur për raste të tilla ekzistojnë edhe raportet e policisë dhe Avokati i Popullit ka vërtetuar këto ngjarje në terren. Sa i përket çështjes së plan-programeve në gjuhën serbe ajo tha se nuk ekzistojnë plan-programe në gjuhën serbe. Ajo tha se në bazë të Pakos së Ahtisarit është garantuar zhvillimi i procesit mësimor në gjuhën serbe dhe në bazë të plan-programeve të Serbisë dhe kjo është arritur edhe në bisedimet ndërkombëtare dhe është e garantuar edhe me Kushtetutë. Sa i përket pagesave të dyfishta ajo tha se nuk është çështje e tyre të merren me këto gjëra. Lidhur me përdorimin e gjuhëve ajo tha se ka informacione se në IAP kanë arritur ankesa të qytetarëve të nacionalitetit serb të fshatit Uglar lidhur me procesin e eksproprijimit dhe marrjen e pronës për nevojat shtetërore. Sa i përket pronarëve të këtyre pronave ajo tha se një pjesë e tyre nuk jetojnë në Kosovë dhe nuk e dinë gjuhën shqipe dhe në mënyrë jo të civilizuar u janë dorëzuar njoftimet për ankesa dhe askush nuk ka arritur në afatin e paraparë për ankesa, sepse njoftimet e tilla janë ndarë në kafene dhe lokale. Ajo pyeti se a janë shqyrtuar këto ankesa që kanë të bëjnë me të drejtën e pronës e cila është e garantuar me Kushtetutë. Ajo tha se këta pronarë nuk kanë marrë kompensimin në të holla dhe nuk kanë pasur mundësi të bëjnë ankesë, sepse informimi ka qenë në gjuhën shqipe dhe nuk janë informuar. Ajo tha se do të kishte qenë mirë që të ngrihet si vërejtje, sepse dokumentet duhet të jenë në dy gjuhë, në bazë të këtyre ngjarjeve ajo tha se serbet dhe shqiptarët nuk janë të barabartë edhe pse kjo gjë është e rregulluar me nenin 5 të Kushtetutës së Kosovës. Ajo tha se ka ankesa edhe te Komuna e Prishtinës në rastin e lëshimit të certifikatës së shtetësisë, sepse ka probleme me alfabetin serb. Ajo tha se kur janë në pyetje mekanizmat e vlerësimit, në cilat gazeta janë të publikuara konkurset dhe a janë ato konkurse të publikuara në gjuhën serbe, sepse sipas saj 10 % e numrit të punëtorëve në institucione i përkasin komuniteteve dhe vetëm 3 % janë të përfaqësuar bashkësitë. Ajo bëri pyetje se ku i botojnë konkurset dhe në çfarë mënyre dhe a kanë ankesa lidhur me publikimin e konkurseve.

**Sami Kurteshi** – Tha se përkthimi i raportit në gjuhën serbe nuk është i drejtë dhe sipas tij nuk ka përkthim profesional nga serbet. Ai tha se nuk do të ketë përkthim kualitativ në gjuhën serbe nëse këtë nuk e bëjnë serbët. Lidhur me çështjen e fshatit Uglar ai tha se kjo do të paraqitet në raportin e vitit 2013, sepse ka ndodhur në këtë vit, por lidhur me këtë çështje ai tha se kanë publikuar një raport special. Lidhur me shpalljen e konkurseve të Institucionit të Avokatit të Popullit ai tha se shpallen edhe në gjuhën serbe, ndërsa sa i përket konkurseve të tjera ai tha se nuk ka njohuri, sepse nuk i përcjellin ato.

**Biserka Kostiq** – Tha se nëse Komuna e Prishtinës nuk ka ndërmarrë veprime lidhur me këtë a ka ndërmarrë IAP-ja ndonjë veprim lidhur me këtë.

**Sami Kurteshi** – Duke u ndërlidhur tha se Avokati i Popullit nuk është organ ekzekutiv dhe nuk mund ta detyrojë askënd që ta kryejë një veprim të caktuar.

**Kymete Bajraktari** – Duke u ndërlidhur me përmbajtjen e raportit theksoi se ai është i përgatitur mjaft mirë dhe përmban shume elemente dhe ka mjaft transparencë. Ajo tha se ka qenë një kërkesë që në raport të përfshihen statistikave se cilat rekomandime janë realizuar dhe cilat jo. Ajo ishte e mendimit se në atë mënyrë do të kishte qenë mjaft mirë që të shihet një pasqyrë e tillë.

**Sami Kurteshi** – Tha se sa i përket transparencës financiare e kanë futur edhe pse nuk është dashur të jetë aty. Sa i përket statistikave të rekomandimeve vërejtja ka qenë me vend.

**Rita Hajzerja – Beqaj** – Ishte e mendimit se më mirë do të ishte që ata si deputet të japin një vlerësim se sa merren parasysh rekomandimet e IAP-së dhe po zbatohen nga institucionet.

**Kymete Bajraktari** – Tha se në raportin e vitit 2011 ka qenë një kërkesë që të paraqitet një tabelë në të cilën figurojnë rekomandimet që janë zbatuar dhe ato të cilat nuk janë zbatuar në raportin e vitit 2012, dhe në këtë mënyrë të vërtetohet se sa po merren parasysh rekomandimet e IAP-së.

**Sami Kurteshi** – Tha se është e nevojshme që ta bëjnë një punim të veçantë lidhur me këtë çështje, sepse në raport nuk mund të futet, sepse ai është raport vjetor dhe ka rekomandime që janë më të gjata dhe nuk mund të zbatohen për një vit.

**Rita Hajzeraj – Beqaj** – Tha se do të ishte mirë që t'i kishin ato statistika dhe gjatë debatit lidhur me raportin të paraqiten edhe ato statistika në mënyrë që të kenë pasqyrën e zbatimit të rekomandimeve të raporteve të kaluara. Në këtë takim ajo tha se nuk do të ketë miratim të raportit deri sa të përmirësohen vërejtjet dhe atëherë do të miratohet në takimet e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

---

Suzan Novoberdali